



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1063 / 14 Prot.

Tiranë, më 07.04 2023

V E N D I M

Nr. 48 dt. 07-04 2023

PËR
DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së neni 25, gërma d), në Vendimin e Senatit nr.06, datë 27.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.07, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023 në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, në shkresën e MAS me nr. 2028 prot., datë 27.03.2023 “Vërtetim njohje dhe njësimi”, si dhe në shkresën e MAS me nr. 2029 prot., datë 27.03.2023 “Vërtetim njohje dhe njësimi”, në Vendimin e Rektoratit me nr. 37, datë 05.04.2023 “Për disa ndryshime në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Senati akademik në mbledhjen e datës 07.04.2023,

V E N D O S I :

- Miratimin dhe ndryshimin e strukturës organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
 - Z. Surven Metolli**, nga “Asistent Lektor” pranë Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndetit, FVFR kalon “Doktor” nga data 18.01.2023 e në vazhdim.
 - Znj. Aisel Oseku**, nga “Asistent Lektor” pranë Departamentit të Shkencave Biomjekësore dhe Humane, FSHR kalon “Doktor” nga data 18.01.2023 e në vazhdim.
- Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

ZËVENDËSMINISTRI

Nr. 2028 Prot.

Tiranë, më 27.3 2023

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Z. Surven Shkëlqim Metolli ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “Fushën e drejtimit profesional 7.4. Kinezioterapi”, në Akademia Kombëtare Sportive “Vasil Levski”, Sofje, Bullgari, më 18.01.2023, nëpërmjet paraqitjes së disertacionit me temë: “Efektet e ushtrimeve stabilizuese në dhimbjen e shpinës, paaftësinë dhe cilësinë e jetës tek adoleshentët e moshës 19-23 vjeç”.

Në mbështetje të Urdhrit Nr. 602, datë 6.10.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave” dhe të vendimit Nr. 4, datë 23.03.2023, të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore, K.Nj.G, të ngritur me Urdhrit Nr. 144, datë 21.03.2023, “Për ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore, ...”, grada shkencore e sipërpërmendur, e fituar në Bullgari, nga Surven Shkëlqim Metolli është e barasvlershme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.

Grada shkencore “Doktor” e Z. Surven Shkëlqim Metolli është regjistruar, me Nr. rendor 775, në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.


Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën e doktoratës.

ZËVENDËSMINISTËR

Albano

ALBANA TOLE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

ZËVENDËSMINISTRI

Nr. 2019 Prot.

Tiranë, më 27.3. 2023

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Znj. Aisel Ali Riza Oseku ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “Fushën e drejtimit profesional 7.4. Kinezioterapi”, në Akademia Kombëtare Sportive “Vasil Levski”, Sofje, Bullgari, më 18.01.2023, nëpërmjet paraqitjes së disertacionit me temë: “Efektiviteti i ushtrimeve terapeutike dhe terapisë korrektuese të frymëmarrjes duke përdorur metodën e Schroth-it në skoliozën idiopatike”.

Në mbështetje të Urdhrit Nr. 602, datë 6.10.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave” dhe të vendimit Nr. 4, datë 23.03.2023, të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore, K.Nj.G, të ngritur me Urdhrin Nr. 144, datë 21.03.2023, “Për ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore, ...”, grada shkencore e sipërpërmendur, e fituar në Bullgari, nga Aisel Ali Riza Oseku është e barasvlershme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.

Grada shkencore “Doktor” e Znj. Aisel Ali Riza Oseku është regjistruar, me Nr. rendor 776 në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën e doktoratës.

ZËVENDËSMINISTËR

Albana Toke
ALBANA TOLE

